

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Strategjia e Biznesit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	III
Semestri:	V
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë synon t'i pajisë studentët me njohuri të avancuara dhe aftësi praktike për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të qëndrueshme brenda një mjedisi biznesi dinamik dhe të globalizuar. Gjatë kursit, studentët do të kuptojnë rëndësinë e integritetit të parimeve të qëndrueshmërisë në proceset vendimmarrëse, me qëllim rritjen e avantazhit konkurrues, zgjerimin e pjesës së tregut dhe maksimizimin e vlerës për aksionarët. Programi mbulon konceptet themelore të menaxhimit strategjik, duke përfshirë formulimin e vizionit dhe misionit, analizën e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, hartimin e strategjive të ndryshme, si dhe adresimin e sfidave globale që prekin organizatat multinacionale. Një fokus i veçantë i kushtohet etikës së biznesit, përgjegjësisë sociale korporative dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, duke promovuar praktika që harmonizohen me tendencat bashkëkohore të tregut, si segmentimi i tregut dhe pozicionimi strategjik i produktit. Përmes studimeve të rasteve dhe analizave praktike, studentët do të zhvillojnë aftësinë për të gjeneruar ide të reja biznesi dhe për të ndërtuar modele të qëndrueshme e inovative, duke kontribuar në krijimin e një ekosistemi biznesor më të përgjegjshëm, konkurrues dhe të orientuar drejt së ardhmes.
Qëllimet e lëndës:	Në përfundim të këtij kursi, studentët pritet të kenë zhvilluar një bazë të fortë të mendimit strategjik dhe një ndërgjegjësim të thellë për rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin modern të biznesit. Lënda synon t'i orientojë ata drejt një kuptimi të avancuar të rolit që luajnë vizioni dhe misioni në drejtimin strategjik të organizatave, duke theksuar njëkohësisht rëndësinë e analizës së mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe përshtatjes së strategjive që adresojnë sfidat mjedisore dhe ekonomike bashkëkohore. Një objektiv qendror i kursit është promovimi i etikës së biznesit dhe përgjegjësisë sociale korporative si shtylla themelore për ndërtimin e modeleve biznesore të përgjegjshme dhe afatgjata. Përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, studentët do të inkurajohen të zhvillojnë aftësi për krijimin e strategjive inovative, për të përballuar sfidat e globalizimit dhe për të ndërtuar

	kompetenca lidershpi të bazuara në përgjegjësi, integritet dhe vizion afatgjatë.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies:	Pas përfundimit të lëndës, studentët pritet të jenë në gjendje: 1. Shpjegojnë konceptet themelore të menaxhimit strategjik dhe të argumentojnë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin bashkëkohor të biznesit. ECTS: 0.75 2. Analizojnë në mënyrë kritike mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të organizatave, duke identifikuar mundësitë dhe sfidat për formulimin e strategjive efektive. ECTS: 0.75 3. Zbatojnë parimet dhe praktikën e qëndrueshmërisë për të hartuar strategji inovative dhe konkurruese. ECTS: 0.75 4. Integrojnë etikën e biznesit dhe përgjegjësinë sociale korporative në proceset vendimmarrëse dhe modelet e zhvillimit organizativ. ECTS: 0.50 5. Vlerësojnë dhe të zhvillojnë strategji ndërkombëtare që adresojnë avantazhet dhe sfidat e operimit në tregjet globale. ECTS: 0.75 6. Përdorin mjete analitike dhe teknika praktike për zbatimin e zgjidhjeve efektive dhe afatgjata në menaxhimin strategjik. ECTS: 1 7. Interpretojnë dhe aplikojnë teoritë dhe praktikën më të mira për të adresuar tendencat e tregut dhe për të përmbushur kërkesat për produkte dhe shërbime të qëndrueshme. ECTS: 0.50		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit - konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi - Test (planifikim + zbatim)	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			25
Përgatitja përfundimtare në provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	3	3
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies:	Kursi zhvillohet gjatë një periudhe 15-javore, me nga 3 orë leksione dhe/ose ushtrime çdo javë, të organizuara si në format individual, ashtu edhe në grup. Ushtrimet synojnë të nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime mbi shembuj konkretë, duke thelluar si njohuritë teorike, ashtu edhe ato		

	praktike. Pjesëmarrja e rregullt dhe kontributi aktiv në ligjërata e ushtrime përbëjnë një komponent kyç të kursit, duke u konsideruar të domosdoshme për zhvillimin e aftësive kritike, analitike dhe bashkëpunuese të studentëve. Studentët inkurajohen të angazhohen në diskutime, të ndajnë mendime dhe të punojnë në mënyrë bashkëpunuese për të ndërtuar një kuptim më të plotë të koncepteve të trajtuara. <i>Metodologjia e kursit kombinon:</i> • Ligjërata teorike për prezantimin e koncepteve dhe parimeve themelore e të avancuara. • Ushtrime praktike për zbatimin e koncepteve në situata reale. • Analizë të rasteve studimore për të lidhur literaturën me praktikën më të mira. • Punime seminarike dhe detyra të strukturuar për zhvillimin e aftësive hulumtuese dhe prezantuese. • Vlerësime periodike për matjen e progresit dhe nivelit të përvetësimit të njohurive. Materialet mësimore do të prezantohen në formate audio-vizuale duke shfrytëzuar teknologjitë bashkëkohore, përfshirë programet e Windows Office dhe mjete të tjera digjitale mbështetëse. Në aspektin teorik, kursi ofron njohuri të bazuara në literaturën shkencore më të fundit, ndërsa pjesa praktike fokusohet në aplikime konkrete, analiza të rasteve nga praktika ndërkombëtare dhe zgjidhje detyrash analitike me interpretim të rezultateve. Ky kombinim synon krijimin e një mjedisi ndërveprues që forcon bashkëpunimin midis profesorëve dhe studentëve, si dhe ndërmjet vetë studentëve, duke rritur cilësinë e të nxënësve dhe aftësinë për të zbatuar njohuritë në situata reale të biznesit.
--	--

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Metoda e vlerësimit – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare:

- Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....**max 20 pikë (%)**,
- Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..**max 10 pikë (%)**,
- Provimi final (ose nga dy teste).....**max 70 pikë (%)**,

Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit:

1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme:

- Aktiviteti në mësim (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjatë ligjëratave.
- Angazhimi (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese.

Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulën e lendes.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë ne korrelacion te plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit te projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulën e lendes.

	3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t’i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t’i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit. Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjëruar. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban: ➤ Pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....30 pikë (%), ➤ Pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....40 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t’i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit - TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	Struktura e këtij moduli është ndërtuar në bazë të një balancimi të kujdesshëm ndërmjet komponentës teorike dhe asaj praktike, me																												

	synim që të sigurohet një përvojë gjithëpërfshirëse dhe efektive. Qasja e integruar synon që studentët fillimisht të ndërtojnë një bazë të qëndrueshme konceptuale, për t'i mundësuar më pas zbatimin e dijes në kontekste praktike dhe situata të afërta me realitetin profesional. Në këtë drejtim, moduli është strukturuar sipas raportit 60% teori dhe 40% praktikë, si vijon: 27 orë (60%) janë të dedikuara për ligjërata teorike, përmes të cilave studentët fitojnë njohuri mbi konceptet themelore të menaxhimit, qasjet teorike, metodologjitë bashkëkohore dhe standardet profesionale, të gjitha të reflektuara në përmbajtjen modulare. 18 orë (40%) janë të orientuara drejt aktiviteteve praktike, duke përfshirë: ➤ Ushtrime në klasë, ➤ Analiza të rasteve konkrete, ➤ Punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi, ➤ Kuize tematike dhe reflektime të strukturuar në fushën e menaxhimit. Në përputhje me këtë strukturë orësh, edhe shpërndarja e 5 ECTS bëhet në mënyrë proporcionale: 2.75 ECTS (55%) i dedikohen përmbajtjes teorike, e cila përqendrohet në ndërtimin e njohurive akademike dhe kuptimit të thellë të tematikave të menaxhimit. 2.25 ECTS (45%) i dedikohen përmbajtjes praktike, duke i orientuar studentët drejt zhvillimit të aftësive analitike, praktike dhe të mendimit kritik përmes aplikimit të koncepteve në raste konkrete. Kjo ndarje përfaqëson një model bashkëkohor të integritetit të teorisë me praktikën dhe synon të përgatisë studentët në mënyrë gjithëpërfshirëse për sfidat profesionale në fushën e menaxhimit.
Literatura	
Literatura bazë	1. Vasilika Kume “<i>Manaxhimi Strategjik</i>”, Teori, koncepte ,zbatime, 2019, Tiranë, Shqipëri 2. Grant, A. (2023). <i>Hidden Potential: The Science of Achieving Greater Things</i>. New York, NY: Viking.
Literatura shtesë	1. Christensen, C. M. (1997). <i>The Innovator's Dilemma: When New Technologies Cause Great Firms to Fail</i>. Boston, MA: Harvard Business School Press 2. Naçi, V., & Bici, A. (2021). <i>Rruga jonë, rruga e suksesit në biznes</i>. Tiranë: Agna Leadership Academy
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	1. A. Loku & R. Temjanovski; Paper: “<i>Fostering Economic Cooperation for Enhanced Benefits in The Western Balkans: Needs, Practices and values</i>”; 2024, Journal: Journal of Educational and Social Research, ISSN: 2239-978X Linku i punimit: https://doi.org/10.36941/jesr-2024-0128
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Përshkrimi (prezantimi) i lëndës,

	Konceptet themelore dhe historiku i shkurter i Menagjimit strategjik dhe rendesia e tij ne zhvillimin e biznesit Literatura: Vasilika Kume “<i>Manaxhimi Strategjik</i>”, Teori, koncepte ,zbatime, 2019,Tiranë, Shqipëri Pp. 5 & 27 Rezultati i pritur nr. 1&4
Java e dytë	Krijimi i filozofise dhe misionit te kompanise Përkufizimi i filozofisë së Organizatës Formulimi i Misionit Qellimet e Kompanise Stakeholders të Organizatës Literatura: Libri i njëjte Pp. 45 – 73 Rezultati i pritur 1, 3 & 6
Java e tretë	Studimim dhe Parashikimi i Mjedisit, analiza konkurruese dhe e mjedisit Rritja e mprehtesise se biznesit tuaj Mjedisi i jashtem Vlersimi i Natyres se mjedisit Njohja dhe parashikimi i influencave te mjedisit Matrica e prioritetit te faktoreve Literatura: Libri i njëjte Pp. 79 – 156 Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 & 6
Java e katërt	Zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria në vendet e Ballkanit perëndimor dhe Inteligjenca Artificiale; Marrëdhëniet tregtare të Ballkanit Perëndimor me BE-në dhe partnerë të tjerë kyç, Reformat strukturore dhe tregu i hapur i punës, përfitimet e bashkëpunimit ekonomik dhe integritimit me BE-në. Literatura: A.Loku & R.Temjanovski, Paper: “<i>Fostering Economic Cooperation for Enhanced Benefits in The Western Balkans: Needs, Practices and values</i>”; 2024 Rezultati i pritur nr. 2, 5 dhe 6
Java e pestë	Analiza e mjedisit të brendshëm Struktura e Organizates dhe kultura Burimet e organizates Analiza SWOT Literatura: Libri i njëjte Pp. 137 - 156 Rezultati i pritur nr. 1, 2 dhe 6
Java e gjashtë	Formulimi i Objektivave dhe identifikimi i alternativave Objektivat e organizates Llojet e strategjive Strategjia konkurruese Strategjia konkurruese me baze tregun Literatura: Libri i njëjte

	Pp. 177 - 194 Rezultati i pritur nr. 1, 3 dhe 6
Java e shtatë	Identifikimi i alternativave strategjike Metodat alternative per zhvillimin e strategjise Strategjite qe duhen shmangur Literatura: Libri i njëjte Pp. 200 - 217 Rezultati i pritur nr. 3, 5 dhe 6
Java e tetë	Testi i Parë
Java e nëntë	Zgjedhja dhe vlersimi i alternativave strategjike Kriteret e vlersimit te strategjise Zgjedhja e alternativave strategjike Vlersimi dhe zgjedhja e alternativave ne nivel biznesi Literatura: Libri i njëjte Pp. 225 - 256 Rezultati i pritur nr. 2, 3, 6 dhe 7
Java e dhjetë	Mjedisi Industrial dhe zgjedhja strategjike Zbatimi i strategjise Struktura e organizates Testimi konkret i solucioneve Literatura: Libri i njëjte Pp. 257 - 272 Rezultati i pritur nr. 1, 3, 6 dhe 7
Java e njëmbëdhjetë	Proceset e organizates Sjellja e organizates Lidhja e kultures me MS Cilat mjete i përshtaten cilit qëndrim themelor? Literatura: Libri i njëjte Pp. 277 - 290 Rezultati i pritur nr. 1, 3, 4 dhe 6
Java e dymbëdhjetë	Zhvillimi i strategjive funksionale Kontrolli i strategjise Procesi i kontrollit strategjik Matja e rezultateve te organizates Revizioni strategjik Literatura: Libri i njëjte Pp. 291 – 306 Rezultati i pritur nr. 2 , 6 dhe 7
Java e trembëdhjetë	Problemet ne matjen e rezultateve Udhëzimet per nje kontroll te sakt Menaxhimi nxites strategjik Problemet per tu studiuar 10 parimet e të menduarit të dizajnit që ripërcaktojnë menaxhimin e biznesit Literatura: Libri i njëjte Pp. 307 – 312

	Rezultati i pritur nr. 2, 4, 6 dhe 7
Java e katërbëdhjetë	Problemet për tu studiuar në veprimtarinë e organizatave Dizajni i Modelit të Biznesit, Një plan strategjik udhëhiqet nga misioni i organizatës, Këshillat e fundit për një plan strategjik, Analiza e gabimeve Analiza e suksesit Literatura: Libri i njëjte Pp. 313 – 350 Rezultati i pritur nr. 1, 2, 6 dhe 7
Java e pesëmbëdhjetë	Testi i dytë dhe Prezantimet përfundimtare Dokumentacioni i projektit të grupit përfundimtar dhe reflektimet Rezultati i pritur nr. 1 - 7
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Një nga shenjat se materiali i lëndës është kuptuar siç duhet është ndershmëria gjatë kryerjes së detyrave. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, ligjëruesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	